



Raport Mujor Shtator 2023

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 2,415,959
Cmimi i kuotës	95.1953
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Kthimi vjetor nga investimi në 30 Shtator 2023	+6.14%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.59% per vitin 2022 ne 31.12.2022
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetë butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i riskut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit



Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet. Obligacionet janë të investuara në titujt të Qeverisë Shqiptare (39.3%), obligacione të korporatave dhe fonde investimi me fokus në obligacione (21%).

Pjesa e aksioneve (29.1%) është e investuar në tregje të zhvilluara: SHBA 17.4%; Zona Euro 7.6%, Britani e Madhe 2.1% e asetëve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është rritur në 10.5% në fund të muajit shtator.

Performanca e fondit

Fondi ka shënuar një ecuri negative mujore prej **-0.44%** gjatë muajit shtator. Tregu i obligacioneve ishte i paqëndrueshëm dhe, në përgjithësi, pati një ecuri negative si pasojë e vendosmërisë të Bankave Qendrore për të mbajtur normat në nivele më të larta për një kohë më të gjatë, gjë që ndikoi dhe në pritshmëritë e tregut. Aksionet performuan njësoj si obligacionet, me çmimet në rënie për një pjesë të madhe të muajit dhe të gjitha indekset kryesore shënuan humbje.

Ecuria e tregjeve financiare në shtator pati një ndikim negativ në portofolin e investimeve të fondit Miks. **Kthimi neto vjetor i fondit Miks është +6.14% më 30 Shtator 2023.**

Ecuria e performancës së Fondit Raiffeisen Miks



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfiturar nje

kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te riskojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Shtator

Rënia e mprehtë në inflacionin e eurozonës në shtator, nga 5.2% në 4.3%, e la atë nën parashikimin konsensual prej 4.5%. Inflacioni në SHBA u rrit në nivelin 3.7% në gusht, nga 3.2% në korrik, sepse një rritje e forte në çmimet e energjisë ndikoi në një rritje të përgjithshme të çmimeve në fund të verës. Ndërkohë, inflacioni bazë u ul në 4.3%, nga 4.7% që ishte në korrik, duke reflektuar ndikimin që çmimet e larta të energjisë kanë në normën e përgjithshme të inflacionit.

Fed e la të pandryshuar normën e saj të politikës monetare në nivelin 5.25%-5.50%, ndërkohë që parashikimi mesatar tregon edhe 1 rritje tjetër të normës prej 25 pikë përqindjeje këtë vit. Banka Qendrore përforcoi pikëpamjen e saj se normat e interesit do të mbeten më të larta për më gjatë.

Vendimi i BQE-së për të rritur normat e interesit me 25 pikë pikë të tjera në 4.50%, më 14 shtator, duket se i jep fund ciklit aktual të politikës shtrënguese. Por, duke mbajtur parasysh qëndrueshmërinë e inflacionit bazë, mesazhi kryesor i Presidentes Lagarde është se politika do të mbetet e shtrënguar për një periudhë të zgjatur.

Tregu i obligacioneve ishte i paqëndrueshëm dhe, në përgjithësi, pati një ecuri negative. Vendosmëria e Bankave Qendrore për të mbajtur normat në nivele më të larta për një kohë më të gjatë, ndikoi negativisht edhe në pritshmëritë e tregut. Yield-et u rritën dhe yield-i i obligacionit 30-vjeçar të thesarit amerikan, arriti pothuajse në 5%. Ky do të ishte niveli më i lartë që nga viti 2007. Nëse yield-et pozicionohen në këto nivele, obligacionet mund të bëhen një alternativë më tërheqëse investimi në krahasim me asetet e tjera më risikoze.

Të gjitha indekset kryesore të aksioneve shënuan humbje gjatë shtatorit, duke përforcuar “efektin e shtatorit”, një fenomen ku kthimet e tregut të aksioneve janë shpesh negative gjatë këtij muaji. S&P ra me 4.87% dhe Nasdaq ra me 5.81%, performanca më e keqe mujore e të dy indekseve që nga dhjetori. Dow Jones humbi 3.5%, performanca e tij më e keqe që nga shkurti. Indekset europiane patën një ecuri më të mirë, por edhe ato e mbyllën muajin me rezultate negative.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dh eforcashitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar t ëkuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyra vetë Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.